

Mrika LIMANI-MYRTAJ
Fatmir ARIFI

**VËZHGIME TË PËRGJITHSHME MBI PROCESIN
EMANCIPUES TË GRAVE SHQIPTARE NË SHEKULLIN XX**

Vështrim i përgjithshëm historik mbi emancipimin e grave

Lëvizjet emancipuese të grave kanë lënë gjurmë të ndjeshme në historinë e zhvillimit të vetëdijes qytetare, por edhe në mënyrë specifike qoftë në pikëpamja teorike në shumë fusha disiplinore, siç është filozofia, sociologjia, letërsia, psikologjia e historia, deri të ato praktike me veprimtaritë konkrete aktive.

Duke qenë se lëvizjet feministe përfshijnë një shumëllojshmëri disiplinash, ato kërkojnë që të të zbulohen hipotezat e fshehta, të cilat shumë studiues i perceptojnë si studime të përgjithshme por që në fakt na dalin se janë vetëm studime me karakter të perspektivës së burrave. Nga perspektiva e filozofisë politike, ideologjitë e majta anojnë nga idetë që rolet tradicionale gjinore, ashtu siç imponohen përmes një tradite të gjatë të ligjërimit dhe imponimit patriarkal, shërbejnë si vegla për të mirëmbajtur role të tilla në shërbim të një sistemi të caktuar ekonomik që mbijeton përmes eksploatimit të fuqisë punëtore. Në këtë kuptim, patriarkati ligjërohet se është sistem mbështetës për feudalizmin, imperializmin dhe kapitalizmin, përderisa i sheh gratë si fuqi punëtore që kryejnë punë riprodhuese, kryejnë punë edhe në sferën publike, por e mirëmbajnë edhe ritmin e punës në sferën private. Nga kjo pikëpamje, një qasje studimore të përafërt e shtron dhe studiuesja E. Amstrong në studimin e saj "*Marxist and Socialist Feminisms*", e cila në mënyrë përmbledhëse thotë se sipas interpretimit socialist, gratë shndërrohen në

fuqi punëtore të rëndësishme për sistemin imperialist dhe kapitalist.¹ Kështu, në rrafshin teorik, diskursi me pikëpamje të majtë në mënyrë të natyrshme kalon te ideja që u ngërthye edhe nga August Bebel në librin e tij *Gratë dhe socializmi*. Sipas tij, nuk ka çlirim të njerëzimit pa pavarësi sociale dhe barazi gjinore.² Lufta për të drejtën e grave, në këtë rast emancipimi i tyre, ka qenë një lëvizje evolutive, por jo si agjendë progresiste dhe paqësore, sidomos që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, e cila njihet në historiografi si lufta për të drejtën e votës, por si pasojë e turbulencave të mëdha globale që kanë qenë të shoqëruar me kriza të sistemeve politike e deri te zhvillimet e luftërave botërore.

Lëvizjet feministe me karakter për barazi socio-ekonomike patën një ndikim të madh jo vetëm në ato qendra ku shpërthenin këto lëvizje si të tilla, por ato u zgjeruan thuajse në nivel global, me disa përjashtime, siç është rajoni i Lindjes së Mesme. Lëvizjet feminsite nuk luftonin vetëm për të drejtën e votës për gratë, si qëllim në vete dhe për vete, por duke e ditur se e drejta e votës siguron pjesëmarrjen aktive në politikë, ‘e drejta të zgjedhësh dhe të zgjidhesh’, është një mundësi më shumë për emancipimin e gruas në mënyrë institucionale dhe integrimin e saj në jetën socio-politike. Përpjekja e parë e organizuar e grave, që e njeh historiografia botërore është lëvizja kombëtare për të drejtat e grave e cila ndodhi në Seneca Falls, të Nju Jorkut në korrikun e vitit 1848.³ Si e tillë, kjo lëvizje u masivizua nga Elizabeth Cady Stanton, e cilat organizoi demonstrata dhe gjeti mbështetje të fuqishme duke ia dhënë lëvizjes edhe një komponent revolucionare.⁴ Stanton, përveç që drejtonte demonstratat, ajo bëri thirrje dhe për një lëvizje të armatosur për realizimin e të drejtave të tyre. Kjo thirrje në historiografi njihet si ‘Deklarata e ndjenjave’.⁵ Padyshim, kjo lëvizje pati ndikim të rëndësishëm në zbatimin më rigoroz të Kushtetutës së SHBA-së. Kushtetuta e SHBA-së, përkundër asaj që

¹ Elisabeth Armstrong, “Marxist and Socialist Feminisms,” *Study of Women and Gender: Faculty Publications*, 2020, 3-4.

² “August Bebel (1840-1913) and His Book *Woman and Socialism* (1879) | Towards Emancipation?,” accessed October 9, 2022, <https://hist259.web.unc.edu/augustbebel/>.

³ The Project Gutenberg e Book of *History of Woman Suffrage, Volume I*, by Elizabeth Cady Stanton, Susan B. Anthony, and Matilda Joslyn Gage, Vol. I, Chapter XIII, f. 456, për më shumë shih: www.gutenberg.org/files/28020/28020-h/28020-h.htm

⁴ David Roediger, *Seizing Freedom: Slave Emancipation and Liberty for All*, Verso, Ney York, 2014, f, 129.

⁵ The Project Gutenberg eBook of *History of Woman Suffrage, Volume I*, by Elizabeth Cady Stanton, Susan B. Anthony, and Matilda Joslyn Gage, f, 70-73, op, cit. për më shumë, shih: www.gutenberg.org/files/28020/28020-h/28020-h.htm

sanksiononte të drejtat e gruas në njërin nga nenet e saj që thotë: “*ne e konsiderojmë këtë të vërtetë si të vetëkuptueshme se të gjithë burrat dhe gratë kanë lindur të barabartë*”⁶, por zbatueshmëria e saj në nivel të ligjeve nuk zbatohet por as nuk interpretohet me një qartësi të duhur.

Mirëpo, Stanton këto të drejta i zbërtheu në disa shtylla në fushatat e saj demonstrative. Ajo rreshtoi pabarazitë e gruas në fushën ekonomike, arsimore, ligjet kufizuese për martesën dhe të drejtat pronësore si dhe normat sociale dhe kulturore që i pengonin gratë t’i gëzonin ndonëse i takonin sipas vetë kushtetutës së SHBA-së, por që në nivel ligjesh ishin mbrapa në zbatueshmëri. Në kuadër të Konventës për të Drejtat e Grave që u mbajt në Seneca Falls, u aprovua një rezolutë me shumë ndikim në kuadër të reformimit të Kushtetutës së SHBA-së⁷. Marrë parasysh tërësinë, format dhe tipologjinë e lëvizjeve feministe në periudha të ndryshme historike, ato ishin të formave revolucionare, të tipit të sindikatave dhe kërkesat e shtruara në thelb ishin sociale dhe me orientim ideologjik të së majtës progresiste. E kundërta e saj, lëvizjet me ideologji të djathtë kanë qenë në masë të madhe me pikëpamje konservatore në përgjithësi për shoqëritë dhe për vetë rolin e gruas në veçanti. Te ideologjitë e djathta, botëkuptimet konservatore për familjen dhe për rolin emancipues të gruas nuk kanë evoluar shumë edhe përkundër transformimeve të ndryshme shoqërore. Kjo qëndron edhe për vendet me një shkallë më të lartë të zhvillimit siç ishin shtetet me demokraci më të avancuar perëndimore (si Franca, Britania e Madhe, Holanda, Gjermania, etj.). Në pikëpamjet ideologjike të djathta, jo vetëm që nuk ka pasur në vetvete agjenda progresiste feministe, ata kanë promovuar qëndrim hermetik konservator dhe patriarkal në raport me pozitën e gruas. Kjo qasje nga ta shpjegohej si e natyrshme dhe e drejtë, e posaçërisht në raport me të drejtën e planifikimit të familjes apo të drejtën për përmirësim të statusit socio-ekonomik në shoqëri.

⁶ Kushtetuta e SHBA-së, i trajtonte si të barabartë njerëzit, por e drejta për të votuar gjinisë femërore iu kishte mohuar. Vetëm në vitin 1919-1920, kjo e drejtë u legalizua, por jo dhe për gratë me ngjyrë. “19th Amendment to the U.S. Constitution: Women’s Right to Vote (1920),” *National Archives*, September 21, 2021, <https://www.archives.gov/milestone-documents/19th-amendment>.

⁷ The Project Gutenberg eBook of History of Woman Suffrage, Volume I, by Elizabeth Cady Stanton, Susan B. Anthony, and Matilda Joslyn Gage, Vol. I, Chapter IV, pg. 68. Për më shumë shih: www.gutenberg.org/files/28020/28020-h/28020-h.htm

Të drejtat e gruas pas Luftës së Parë Botërore

Lëvizjet emancipuese të cilat kanë pasur ndikim në botën perëndimore, zakonisht burimin e tyre e kanë në SHBA. Gratë amerikane kishin luftuar për të drejtën e votës për dekada përpara ratifikimit të Amendamentit të 19 të 18 gushtit të viti 1920, por vetëm kah fundi i Luftës së Parë Botërore kauza e tyre për pavarësi politike e sociale rifitoi vrullin e saj.⁸ Në këtë fazë historike kur lufta ishte e përmasave botërore dhe ngaqë lufta shfaqti paqartësi për të ardhmen, roli i gruas doli në pah si një nga shtyllat më të rëndësishme të shoqërisë. Përderisa burrat ishin të angazhuar në frontet e luftës, zhvillimi i industrisë kishte ngecje të theksuar si pasojë e mungesës së fuqisë punëtore. Me këtë rast u pa si një mundësi që këtë mungesë të punëtorëve në shumë sektorë ta plotësonin me angazhimin e gruas. Në këtë rrafsh, filluan të ndryshonin në mënyrë thelbësore qëndrimet publike dhe institucionale ndaj rolit të gruas në shoqëri. Në një nga fjalimet e tij, në Kongresin Amerikan në vitin 1918, Presidenti Woodrow Wilson pranoi se roli i grave në përpjekjet e luftës është jetik.⁹ Ai iu drejtua kongresit me një serë pyetjesh duke theksuar *“Ne i kemi bërë partnere gratë në këtë luftë... a duhet t’i pranojmë ato vetëm në një partneritet vuajtjesh, sakrificash dhe mudi dhe jo në një partneritet për privilegje...?”*¹⁰ Për sa i përket projekt-propozimit të Wilsonit për të drejtat e grave në Kongresin Amerikan, ai nuk mori mbështetje dhe si rezultat nuk mori as vota të nevojshme për plotësim të amendamenteve kushtetuese. Në realizimin e plotësimi të amendamentit kushtetues, për të drejtat e grave, Wilsoni filloi lobimin me kongresmenët ndaj dhe në qershor të vitit 1919, kaloi amendamenti 19 kushtetues në Dhomën e ulët të përfaqësuesve dhe iu dërgua shteteve për ratifikim.¹¹ Ky avancim në kuadër të të drejtave të grave dhe emancipimin e tyre, perceptohet nga shumë studiues si avancimi i një vullneti apo agjende progresiste të barazisë gjinore për periudhën në fjalë. Në anën tjetër, të drejtat e grave dhe emancipimi i tyre kishin evoluar vetëm në kohë krizash globale, siç mund të themi kriza të sistemeve

⁸ “Women’s Suffrage and WWI (U.S. National Park Service),” accessed November 21, 2022, <https://www.nps.gov/articleswomens-suffrage-wwi.htm>.

⁹ Për një lexim më të zgjeruar shiko edhe:

<https://www.wilsoncenter.org/article/woodrow-wilson-and-the-womens-suffrage-movement-reflection>

¹⁰ Po aty. <https://www.wilsoncenter.org/article/woodrow-wilson-and-the-womens-suffrage-movement-reflection>

¹¹ Po aty.

politike ose kriza ekonomike. Andaj, në këtë rrafsh praktik, lëvizjet feministe, duke u nisur nga retorika që përdornin udhëheqësit shtetërorë për mobilizim në kuadër të Luftës së Parë Botërore, forcuan angazhimin e tyre dhe vunë në dukje rolin kyç të grave në proceset shoqërore të brendshme dhe forcuan argumentet e tyre në favor të zgjerimit të drejtave të tyre.

Pozita e grave shqiptare në mes të dy luftërave botërore

Në hapësirën gjeografike shqiptare, pas Luftës së Parë Botërore pozita e gruas nuk pati ndonjë avancim, përkundrazi, ajo mbeti e marginalizuar. Përkundër ndikimit të rilindësve, si një lëvizje kulturore, të cilët figurën e gruas e panë që herët përtej traditës zakonore, arsimimi dhe emancipimi i saj mbeti krejtësisht periferik për shkaqe të ditura si pasojë e mungesë së një strukture shtetërore të konsoliduar. Siç e thotë dhe studiuesja H. Mico, për sa i përket zhvillimit të arsimit në këtë periudhë: *“ai e kishte fizionominë e vet zhvillimit të shtetit shqiptar”*¹². Është e ditur se në këtë periudhë shteti shqiptar ishte duke u ballafaquar me shumë sfida, duke filluar nga përpjekjet për të siguruar subjektivitetin ndërkombëtar deri te çështjet e brendshme e ato financiare. Në këtë kuadër, çështja e arsimit nuk ishte e lënë pas dore, por kapacitetet e shtetit shqiptar ishin të kufizuara, ndonëse për një gjë të tillë kanë shkruar dhe rilindësit shqiptarë duke tërhequr vëmendjen për gjendjen e mjerueshme të gruas shqiptare në raport me të drejtat e grave të shteteve evropiane. Gjatë periudhës republikane dhe mbretërore nuk pati ndonjë avancim të dukshëm në shkollimin dhe emancipimin e gruas shqiptare si kategori më vitale e shoqërisë. Një portret të tillë të gjendjes e ofron dhe shtypi i kohës, siç ishte gazeta *Ora*, ku në një artikull të vitit 1929 thuhej: *“...mjafton të shënojmë që femrat shqiptare po mbeten në errësirë dhe duhet plotësur sa më shpejt kjo e metë...”*¹³. Sipas këtij shkrimi, pyetja që duhet trajtohej është se cilët ishin faktorët që gruan shqiptare e kanë lënë në errësirë, siç potenciohej aty? Janë një sërë faktorësh si të tillë, të cilat në kuadër të kornizave të këtij punimi, nuk mund të trajtohen që të gjitha, por do t'i marrim disa më thelbësorët.

Së pari, hapësira gjeografike shqiptare ka qenë nën pushtime të gjata të huaja. Çdo pushtues impononte mendësinë, botëkuptimet, kulturën

¹² Heliona Mico, “Vështrim historiko-juridik mbi zhvillimin e të drejtës së arsimit në shtetin shqiptar, 1920-1939”, Studime historike, 3-4/2016, Tiranë, f. 121.

¹³. Gazeta, “Ora”, 1929, f. 12.

e tij dhe sistemin politik kundrejt shqiptarëve, varësisht nga vinin ata pushtues. Duke marrë për bazë që pushtimet ishin të njëpasnjëshme, çështjet e arsimit dhe emancipimit, ishin të kushtëzuara varësisht se cili pushtues dominonte. Ato pak shkolla që ishin të hapura, jo që nuk ishin shkolla kombëtare shqiptare, por dhe më keq, nuk lejohej përdorimi i gjuhës shqipe, por vetëm përdorimi i gjuhës së pushtuesit si p.sh.: gjuha turke, greke e më vonë dhe ajo italiane pas vitit 1939. Për më tej këto shkolla zakonisht kishin karakter religjioz dhe dogmatik siç ishin mejtepet, shkollat kishtare, dhe pa ndonjë frymë që i shërbente emancipimit të gruas.

Së dyti, implikimi religjioz ka pasë ndikim në mënyren sesi planifikohej dhe praktikohesh sistemi i arsimit, varësisht nga ndikimi fetar i lindjes apo i perëndimit. Kjo praktikë bëri që sistemi i arsimit në Shqipëri të ishte shumë i larmishëm. Siç trajtohet dhe në njërin nga vëllimet e Historisë së Popullit Shqiptar për sa i përket kësaj problematike, ndër të tjera shkruan: “...përveç kësaj, një numër i madh shkollash drejtohej e administrohej nga tri komunitetet fetare, me programe të veçanta dhe që i ndanin nxënësit sipas besimeve”.¹⁴ Një praktikë e tillë nuk i kontribuoi aspak emancipimit të gruas.

Së treti, dominimi i një feudalizmi konservator dhe shumë i prapambetur në nivel shoqëror, politik dhe ekonomik ka pasë ndikim negativ. Në këtë fazë duke qenë se shoqëria ishte shumë hierarkike, duke bartur reminishenca të së kaluarës, siç ishte, mbreti, kisha dhe fisnikëria, pushteti ndikohesh jashtëzakonisht shumë nga pushtetarët të cilët zotëronin prona të mjaftueshme, duke e pamundësuar kështu ngritjen e një shtrese të mesme të shoqërisë. E gjithë ekonomia e kësaj periudhe bazohesh në bujqësi me ç’rast toka ishte në duart e feudalëve gjë që prodhoi një shtresë të shoqërisë shumë të varfër dhe një koniunkturë shoqërore shumë të pasur. Siç është e vërtetuar, në një shoqëri ku ka një shtresë shumë të varfër dhe një shumë të pasur, duke munguar shtresa e mesme, zhvillimi shoqëror gjithnjë ka turbulenca. Kjo sepse është shtresa e mesme ajo që ekuilibron parimisht dy shtresat e tjera ekstreme. Prandaj dhe në kuadër të këtij sistemi, çështja e emancipimit të gruas shqiptare mbeti në margjina. Së fundmi, shoqëria shqiptare me shekuj iu ka nënshtruar ligjeve diskriminuese. Në këtë rrafsh historik, në mungesë të ligjeve civile, në shumë zona të gjeografisë shqiptare dominonte e drejta zakonore-kanunore. Është për ta theksuar se në hapësirën shqiptare përveç Kanunit,

¹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2007, f. 188-189.

i njohur si “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, kanë dominuar dhe një sërë kanunesh me ndikime krahinore siç ishte edhe “Kanuni i Labërisë”. Pavarësisht dallimeve të tyre, krejtësisht simbolike, gruaja në kuadër të këtyre neneve kanunore trajtohej si një pronë e burrit dhe gjendja e saj ekonomike ishte e varur.

Kjo e drejtë kanunore, për shekuj e mbajti gruan shqiptare peng. Përveç që nuk lejonte të drejtën ekonomike sociale të vajzave dhe grave shqiptare, ajo i privonte ato dhe nga e drejta e trashëgimisë siç ishin prona dhe e drejta mbi kujdestarinë e fëmijëve të saj. Në një nga nenet e saj shkruhej: “*Kanuja njeft për trashëgues djalin e jo vajzën*”¹⁵.

Përkundër këtyre zakoneve të prapambetura, rilindësit shqiptarë përmes shkrimeve të tyre, sa do që ishin të kufizuara, lanë gjurmë në emancipimin shoqëror. Është për të evidentuar se Rilindja Kombëtare Shqiptare, si lëvizje, fillimisht kulturore e më vonë edhe politike, me orientim socialdemokrate, emancipimit të gruas i kishte dhënë një prioritet në kuadër të mundësive të tyre. Megjithatë, emancipimi i gruas shqiptare mbeti në nivel të ulët, jo për fajin e tyre, por për shkak të faktorëve që i radhitëm më sipër. Siç është e dokumentuar, shkolla e parë shqipe që ka lënë gjurmë në emancipimin e gruas shqiptare është shkolla që ishte hapur në Korçë më 1887, e cila pati karakter kombëtar pa dallime gjinore apo sociale dhe pa ndonjë ndikim të theksuar religjioz. Modelin e gjimnazit të Korçës e kishte marrë dhe qeveria shqiptare e vitit 1912-1913, e cila sanksionoi arsimin fillor si të detyrueshëm, por nuk pati jetëgjatësi, për sa i përket qeverisjes së saj.¹⁶ Edhe Kongresi i Lushnjës më 1920 dhe kongreset që u zhvilluan në Tiranë më 1922 dhe 1924, ndihmuan shumë në arsimin dhe emancipimin e gruas, jo vetëm në përhapjen e frymës, por dhe në aprovimin e laicitetit të sistemit arsimor si dhe të një unifikimi të tij.¹⁷ Ndërsa, pas revolucionit demokratik të qershorit të vitit 1924, me të cilin në krye të shtetit erdhi Fan Noli, në raport me shkollat shqipe dhe emancipimin e grave shqiptare nuk pati ndonjë ndryshim si pasojë e jetëgjatësisë së qeverisë Noli. Për sa i përket periudhës së qeverisjes republikane apo mbretërore të Ahmet Zogut, përkundër nismave për progres civil, nuk pati ndonjë ngritje të duhur, e aq më pak në raport me emancipimin e gruas shqiptare. Nuk ka dyshim që në shtypin e kohës,

¹⁵ Kanuni i Lekë Dukagjinit, kapitulli i gjashtë, neni tridhjetë e tre. Për një lexim më të zgjeruar lexo shih: <https://kanuni.org/pub/documents/c20b1073/kanuni.pdf>

¹⁶ Fatmira Rama, *Dukuri arsimore gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri*, Tiranë, Argeta- LMG, 2005, f. 11.

¹⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi i III, vep. cit. f. 188-190.

propagandohej lidhur me emancipimin e gruas përmes arsimit, por në çështje zyrtare shtetërore nuk pati ndonjë lëvizje të prekshme. Për më tej nga viti 1927-1928 pati dhe ngecje të tepruar të arsimit si pasojë e vendimit të ministrit të Arsimit, i cili kërkoi kufizimin e arsimit fillor në fshatra, me ç'rast krijoi shumë pakënaqësi në popullsinë shqiptare¹⁸.

E gjithë ajo që ishte si infrastrukturë arsimore, që nga viti 1920 e deri në shpalljen e monarkisë, Shqipëria, qoftë në arsimin shtetëror apo privat, numri i nxënësve nuk kalonte më shumë se 27 000. Në këtë kuadër bëjnë pjesë dhe nxënësit që ndiqnin mësimin nëpër shkolla religjioze, tek të cilat mësimi mbahej në gjuhë të huaj, qoftë greqisht apo italisht. Për sa i përket numrit të vajzave, ai ishte fare simbolik. Siç e dëshmon dhe një shkrim në gazetën *Ora*, të vitit 1929, ndër të tjera shkruhej se “... këto shifra tregojnë se sa prapa është arsimi femëror, në krahasim me atë mashkullor...”¹⁹.

Vetëm në vitin 1933, pati një përpjekje institucionale për avancimin e arsimit shqip dhe në këtë rast dhe për emancipimin e grave. Në këtë vit nga parlamenti shqiptar u aprovua dekretligji për organizimin e sistemit arsimor me synim që të pakësoheshin në shkolla ndikimet e huaja. Me këtë rast u synua të bëhej shtetëzimi i shkollave fillore dhe të mesme, e cila nuk kaloi pa pasoja, me që pati reagime imponuese, qoftë nga Greqia po ashtu dhe nga Italia²⁰.

Pozita e gruas shqiptare nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene

Pozita e gruas shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë dhe emancipimi i saj ishte në një nivel tejet i ulë. Çështjes së arsimit shqip në këto vise, dhe kur flasim për arsimin duhet ta vëmë në pah emancipimin e gruas shqiptare, jo që nuk iu dha prioritet, por ishte e ndalur tërësisht nga mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene dhe më pas ajo Jugosllave. Përkundër asaj që Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore u bë pjesë e nënshkrimit të traktatit me Lidhjen e Kombeve në vitin 1919 (Traktati i Sen Zhermenit), duke marrë dhe obligime për sigurimin e arsimit fillor në

¹⁸ Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë, Fondi 195, MA, viti 1927, dosja 5, fleta 1-14.

¹⁹ Gazeta, “Ora”, op. cit, 1929, f. 12.

²⁰ Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë, Fondi 149, “Raporti i Ministrisë së Arsimit dërguar kryeministrit”, dosja IV, viti 1935, fleta 15.

gjuhën e popujve që e përbënin atë, për sa i përket arsimit në gjuhën shqipe, kjo marrëveshje nuk u zbatua. Siç e përshkruan dhe studiuesi, Malcolm: *“Këto garanci, sidomos për gjuhën nuk u përfillën haptazi. Shkollat që ishin hapur gjatë pushtimit austriak ose u mbyllën ose u shndërruan në shkolla vetëm në serbisht”*. Për më tej Malcolm thekson: *“... u lejuan disa mejtepe dhe shkolla private turke me kusht që mësimi të zhvillohej turqisht”*.²¹

Gjithnjë sipas këtij studiuesi, deri në vitin 1930 në mbarë Kosovën nuk kishte shkolla shqipe²². Autori nuk e jep me saktësi këtë burim, por në të dhënat që ofron historiografia shqiptare, çështja e arsimit në gjuhën shqipe fillon vetëm pas rënies së Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, si pasojë e pushtimit fashist.

Në rrethana të tilla, në kuadër të një monarkie, e cila kishte program politik shfarosjen e shqiptarëve përmes dhunës sistematike, jo që mund të bëhej fjalë për ndonjë lëvizje emancipuese të gruas shqiptare, por e gjithë përpjekja e shqiptarëve ishte e koncentruar për mbijetesë si qenie njerëzore dhe etnike.

Pozita e gruas shqiptare gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, lëvizjet feministe dolën në pah me një rol edhe më të rëndësishëm në mbarë botën. Historia na jep shumë shembuj për pjesëmarrjen e grave në zhvillimet e proceseve të ndryshme socio-politike, e sidomos në periudhat e luftërave të mëdha siç ishin dy luftërat botërore. Duke i përjashtuar këto dy luftëra, lëvizjet emancipuese dhe socio-politike të gruas në periudha të ndryshme ishin më shumë të natyrës individuale se sa të ndonjë fryme të organizuar në nivel shtetëror. Me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, roli i gruas mori përmasa organizative, në nivel institucional. Ky organizim si pasojë e pushtimit të nazifashizmit, qoftë në shtetet perëndimore, pavarësisht frymës ideologjike, qoftë në ato lindore që dominonte ideologjia e majtë, doli në pah me një shkallë më të theksuar. Përkundër këtyre paradigmave ideologjike përjashtuese njëra me tjetrën, kontributet e gruas filluan të jenë më të sistemuar dhe të vlerësuar si të një rëndësie të veçantë.

²¹ Neol Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha & Shtëpia e Librit Tiranë, 2001, f. 278.

²² Po aty, f. 278.

Për sa i përket Shqipërisë, pavarësisht që u organizua në baza vullnetare në kuadër të Aleancës Antifashiste²³, gratë shqiptare iu bashkuan Luftës Nacionalçlirimtare si domosdoshmëri e kohës, ndonëse ky organizim ishte në kuadër të një fryme me ideologji të majtë dhe për kohën ishte shumë atraktive. E majta në këtë fazë historike përfaqësohej nga shtresa e rinisë, e cila përbënte më shumë se gjysmën e popullsisë shqiptare.

Siç e saktëson dhe studiuesi B. Zotaj, *“Mbi 6 000 gra dhe vajza dolën në këtë luftë, e dhanë kontributin e tyre për çlirimin e vendit. Ato thyen mjaft koncepte dhe u radhitën përkrah burrave në këtë epike, duke dhënë dhe jetën për çlirimin e vendit. Ato flakën tej zakonet dhe thyen tabutë e kohës, duke u bërë shembull frymëzimi në Luftën Nacionalçlirimtare”*.²⁴

Gratë shqiptare duke u bërë pjesë e luftës, ato morën angazhim konkret në emancipimin e tyre politik dhe shoqëror, duke u bërë pjesë e formacioneve politiko-ushtarake që nga viti 1942 e këndeje. Fillimisht përmes aktivave, ato arritën që të krijonin organizatën e tyre të njohur si “Bashkimi i Gruas Antifashiste Shqiptare” në kuadër të Frontin Nacionalçlirimtare, duke mobilizuar deri në nivel kongresin e tyre në vitin 1943/44. Organizata, Bashkimi i Gruas Antifashiste Shqiptare, duke vlerësuar si të nevojshme ngritjen e një organi të shtypit, i cili do të i shërbente çështjes kombëtare por njëkohësisht dhe ngritjes së vetëdijes së gruas, ato nxorën revistën ilegale të quajtur “Gruaja shqiptare” e cila doli në korrik të vitit 1943²⁵. Si e tillë organizata e gruas antifashiste mori pjesë dhe në Konferencën e Pezës, Labinotit etj. me të drejta të barabarta në luftën nacionalçlirimtare dhe roli i tyre u shtua në fushën e propagandës që bënin kundër nazifashizmit, mobilizimin e kurseve kundër analfabetizmit si komponent emancipues dhe luftën kundër stereotipeve të një patriarkalizmi të prapambetur. Në këtë kuadër, roli i gruas shqiptare, sipas dokumenteve të kohës, na del i pakontestueshëm dhe shumë i vlerësuar në luftën antifashiste nacionalçlirimtare. Në një nga direktivat e Komitetit Qendror të PKS-së, përveç tjerash, rekomandohej: *“me autorizimin e Komitetit Qendror, është marrë iniciativë dhe u është dërguar gjithë*

²³ Arben Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Botime Toena, Tiranë 2009, f. 681-686.

²⁴ Bernard Zotaj, *Gruaja shqiptare në Luftën Partizane*, nëntor 2018, për një lexim më të zgjeruar shih: <https://telegraf.al/dosier/gruaja-shqiptare-ne-luften-partizane/>

²⁵ Bernard Zotaj, *Gruaja shqiptare në Luftën Partizane*, nëntor 2018, për një lexim më të zgjeruar shih: <https://telegraf.al/dosier/gruaja-shqiptare-ne-luften-partizane/>

*qarkorëve një qarkore, me të cilën këshilloheni që të filloni punën për krijimin e organizatës së Bashkuar të Gruas Antifashiste Shqiptare... ”.*²⁶

Në fazën që po flasim, çështja e emancipimit të gruas tanimë nuk ishte një lëvizje spontane, por ajo doli me një rol dominant dhe fitues në të drejtat e tyre të barabarta me burrat. Praktikisht në këtë periudhë të drejtat e grave morën formë juridike me një vendim të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, duke i bërë ato pjesë e të gjitha formacionet partizane por dhe në kuadër të Këshillave Nacionalçlirimtarë, si në rrethe, qytetet e qarqe të caktuara. Nuk ka dyshim që kjo e arritur e emancipimit të gruas shqiptare, duke qenë më prezent në të gjitha proceset për çlirimin e vendit, dhe në organizmat drejtues siç ishin konferencat e vendit duke filluar nga ai i Përmetit, Beratit, Labinotit, Pezës në Mbledhjen e Dytë Antifashiste Nacionalçlirimtare, nëntorit të vitit 1944, e drejta e gruas mori formën krejtësisht të dalluar nga një sistem socio-politik pararendës, me ç’rast u sanksionua në Kushtetutën e parë të Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore²⁷. Marrë në përgjithësi, në të gjitha aktet juridike duke filluar nga akti më i lartë siç është Kushtetuta, pozita e gruas, ndonëse niveli arsimor i saj ishte jashtëzakonisht i ulët, siç ishte i tërë popullsisë shqiptare, u përmirësua dhe u bë e barabartë në të gjitha institucionet shtetërore, por dhe njëkohësisht u vendos që gruaja shqiptare të jetë në të gjitha pozitat e ngjashme me gratë e shteteve më të zhvilluar të kohës.

Kjo ishte si rrjedhojë e vet angazhimit të grave, për emancipimin e tyre, të cilat e gjetën veten më të përfaqësuar në kuadër të një ideologjie, që për kohën ishte më atraktive për faktin se emancipimin e gruas e kishte në qendër të saj. Natyrisht, pas luftës kishte probleme nga më të ndryshmet dhe emancipimi i gruas hasi në shumë pengesa të asaj kohe si pasojë e një patriarkalizmi dhe konservatorizmi që ishte i trashëguar nga sistemet socio-politike të mëhershme. Për ta përmbysur këtë botëkuptim patriarkal, qeveria e atëhershme zhvilloi një luftë në shumë dimensione si kundër botëkuptimit feudal, konservator e fetar, duke tentuar që të minimizojë mbretërimin e kësaj frymë në familjet shqiptare përbrenda kontekstit të ri politik që u formësua.²⁸

²⁶ Gruaja shqiptare - Faktor i rëndësishëm në Luftën Nacionalçlirimtare, “*Qarkore drejtuar komiteteve të Partisë Komuniste të Shqipërisë në qarqe*, 14 prill 1943, Enver Hoxha, Vepra, I. Për më shumë lexo, 8.40-49. pdf (enver-hoxha.net), f, 352-355; Enver Hoxha, Vepra, II, 1968, f, 20, 21. Për më shumë lexo: 1.1-5.pdf (enver-hoxha.net)

²⁷ *Zëri i popullit*, Nr. 634, 11 janar, 1947.

²⁸ Enver Hoxha, Vepra 3, f, 476, për më shumë lexo online: 10.62-64.pdf (enver-hoxha.net)

Në tërësinë e saj, pas Luftës së Dytë Botërore emancipimi i gruas mori përmasa në të gjitha dimensionet e jetës shoqërore, si në punësim, edukim dhe të drejta të barabarta.

Pozita e gruas shqiptare në Kosovë dhe viset e saj aneksuar Jugosllavisë, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore

Për sa i përket lëvizjeve emancipuese të gruas shqiptare në kuadër të Jugosllavisë, përgjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, kjo bënë diferencën në raport me Shqipërinë, siç bënë diferencë me shumë shtete që mbetën nën influencën e ideologjisë komuniste të pas Luftës së Dytë Botërore. Për të trajtuar këtë temë që është në fokusin tonë ne nuk mund ta shohim emancipimin e gruas vetëm nga prizmi institucional, por edhe nga elementet e tjera si ndikimi i traditës, kulturës, religjionit. Çështja duhet të shtrohet më thellë, duke marrë për bazë përveç anës gjeopolitike, gjeostrategjike, edhe karakteristikat dalluese të kombeve që përbënin këtë shtet antiidentitar, lëvizjet arsimore dhe emancipuese janë shumë të pakta. Sipas referencave, bashkimi i sllavëve të jugut u ligjërua 90 vjet para themelimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene (Jugosllavisë së parë).^{*} Së pari, Jugosllavia, si ide, e më vonë edhe për shkak të rrethanave gjeopolitike u dizajnuar me qëllim bashkimin e të gjithë sllavëve të jugut në një shtet të vetëm. Natyrshëm, u krijua një shtet antiidentitar i themeluar si pasojë e raporteve gjeopolitike të kohës, të cilat shpeshherë kanë qenë të kushtëzuar në shërbim të raporteve të baraspeshës së marrëdhënieve ndërkombëtare.

Nga rrafshi i kësaj premise historike, çështja shqiptare, veçanërisht Kosova me viset e saj aneksuar Jugosllavisë, gjeneratë pas gjenerate te shqiptarët ishte përjetuar si një dramë e rëndë kombëtare. Kjo dramë duhet të shikohet, të studiohet dhe të kuptohet drejt për sa i përket popullsisë shqiptare nën regjimin e tri Jugosllavive. Problemin duhet ta shtrojmë aty ku fillon gjeneza. Është për t'u theksuar se çështja e Kosovës, si e tillë u krijua pas Luftës së Parë Ballkanike në tetor të vitit 1912 dhe nga ajo kohë ajo konsiderohej si bërthamë e çështjes së pazgjidhur kombëtare. Përgjatë

^{*} Bashkimi i sllavëve të Jugut si ide ka lindur në vitin 1830. Për më shumë lexo: Yugoslavism, histories of a Failed Idea 1918-1992, f, 12-14, editor Dejan Djokic, 2003. Një lexim më të zgjeruar: https://books.google.com/books?id=ZMyZdvTympMC&printsec=frontcover&source=gb_s_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false

kësaj periudhe, si pasojë e reformës agrare, ishte zhdukur çdo strukturë socio-politike, qoftë e tipit ideologjik të majtë apo të djathtë.

Praktikisht, viset shqiptare që ishin nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene bënë përpjekje për ekzistencë, ndërkaq i nënshtroheshin dhunës si politikë shtetërore serbe kundrejt shqiptarëve. Është për t'u theksuar se viti 1912 është pika kur tanimë politikat për shkombëtarizimin e Kosovës, bëhen politika zyrtare shtetërore serbe. Deri në vitin 1921, popullsia e viseve të okupuara nën Serbi dhe Mali të Zi, iu nënshtruan një ploje të egër nga ushtritë e këtyre dy shteteve të fundit, me qëllim asgjësimin e elementit shqiptar. Me qindra fshatra shqiptare janë djegur në themel dhe u konfiskua pasuria e tyre.

Ky agresivitet shtetëror transgjeneracional kundrejt shqiptarëve e krijoi një qasje mosbesuese të shqiptarëve në raport me jugosllavët që jehoi edhe në periudhat pasuese. Kjo u reflektua dhe përgjatë Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, ndonëse Partia Komuniste e Jugosllavisë, doli fillimisht me teza për barazi etnike për të gjithë popujt që jetonin brenda saj. Megjithatë, për shqiptarët në viset jashtë Shqipërisë londineze, trashëgimia e shkombëtarizimit kundrejt shqiptarëve, qoftë nga Jugosllavia e vjetër apo e reja, jo që ishte mosbesuese, por ajo pati dhe vazhdimësinë e të kaluarës së saj. Prandaj dhe përgjatë gjithë Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë dhe viset e saj, nuk pati ndonjë lëvizje të organizuar të karakterit emancipues të gruas shqiptare. Në këtë rrafsh nuk ka ndonjë referencë ku gruaja shqiptare përfaqësohej në kuadër të Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, siç mund t'i referohemi organizatës së gruas shqiptare në Luftën Nacionalçlirimtare të Shqipërisë. Kjo ishte si pasojë se komunizmi jugosllav, i dominuar nga serbët, trashëgoi shumë elemente të shkombëtarizimit shqiptar jo vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore, por dhe pas saj. Lidhur me këtë dokumentohet të 3 nëntorit të vitit 1944, Vasa Çubriloviq e dorëzoi elaboratin e dytë të tij për shfarosjen e shqiptarëve me synim që të zvogëlojnë numrin e popullsisë shqiptare dhe për ta kthyer Kosovën në një koloni "jozyrtare"²⁹. Jo rastësisht, në këtë muaj, më 21 nëntor 1944, Kryesia e AVNOJ-it, do të merrte vendim ligjor për t'i amnistuar të gjithë lëvizjen çetnike. Nga ky moment, forcat e lëvizjes çetnike dhe forcat serbo-malazeze partizane u amalgamuan dhe drejtoheshin në nivel të Shtabit Qendror të PKJ-së, duke anashkaluar Shtabin Operativ të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit, siç ishte emërtuar atëherë.

²⁹ Për një lexim më të zgjeruar lexo:

http://www.albanianhistory.net/1944_CubriloVIC/index.html

Përkundër disa reformave që kishin nisur nga vitet e '60-'70, reminishenca dhe diskursi i një mendësie të së kaluarës ishte shumë prezent. Siç e thekson dhe studiuesi Anthony Whitehead, se “*etnologjia serbe është një fusnotë e Cvijiqit*³⁰”. Një referencë të tillë e konstaton dhe studiuesi Mark Krasniqi, i cili në kuadër të kujtimeve të tij të botuara në vitin 2012, shkruan se: “*Studiuesit serbë nuk kishin hequr dorë së ngjyeri pendën në këtë ideologji edhe pse “druheshin e ruheshin”, nga konteksti i ri jugosllav*”.³¹

Kjo argumentohet edhe me atë se dy dekada pas Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës dhe viseve të saj, iu kanë nënshtruar, përsëri një politike shkombëtarizuese dhe asimiluese, si pasojë e doktrinës së Komitetit Qendror të Jugosllavisë e njohur si “Aksioni i mbledhjes së armëve”, e cila ishte implementuar nën mbikëqyrjen personale të Titos dhe Rankoviçit³². Kjo doktrinë politike zgjati deri në vitin 1966, me ç’rast për dy dekada, u artikuluan shumë metoda, strategji, veprime praktike në terren se si të margjinalizohen shqiptarët që tanimë jetonin padrejtësisht nën Jugosllavi. Në këtë fazë, referencat arkivore që janë të hapura janë të njohura dhe citimet mund të jenë të tepërta për veprimtarinë jugosllave antishqiptare siç mund të merret regjistrimet e popullsisë, të vitit 1948, dhe të vitit 1953³³, ku shqiptarët iu ishin nënshtruar dhunës që të regjistroheshin si turq, apo të një nacionaliteti tjetër. I sollëm si parantezë këto referenca, për të argumentuar se idetë e Partisë Komuniste të Jugosllavisë në Kosovë dhe viset e saj, nuk janë pranuar si ide atraktive

³⁰ Wendy Bracewell, “Eating Up Yugoslavia”, përmbledhje në: *Communism Unrapped: Consumption in Cold War Eastern Europe*, edited By Paulin Bren and Mary Neuburger, Neë York, Oxford University Press, 2012., cituar sipas Arsim Canollit, “Nga gurra e traditës te gurra e kritikës”: Aspekte të mendimit etnologjik të Mark Krasniqit, file:///C:/Users/Acer/Doënloads/antropologji_2020_canolli_arsim_5-42%20(1).pdf

³¹ Cituar sipas Arsim Canollit, “Nga gurra e traditës te gurra e kritikës”, file:///C:/Users/Acer/Doënloads/antropologji_2020_canolli_arsim_5-42%20(1).pdf

³² Platforma shtetërore e Jugosllavisë për shpërnguljen e shqiptarëve, pas Luftës së Dytë Botërore, e njohur në opinion si: “Aksioni i mbledhjes së armëve”, u iniciua nga Tito dhe u mbikëqyr drejtpërdrejt nga zv/kryetari i Jugosllavisë dhe njëkohësisht dhe ministër i Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, Aleksandër Rankoviç. Realizimi i kësaj platforme, që në thelb kishte për qëllim ndryshimin e demografisë së popullsisë në viset shqiptare jashtë Shqipërisë londineze, u implementua nga Sigurimi Shtetëror i Jugosllavisë, i Republikës së Serbisë dhe i elementëve të Kosovës. Për një studim më të detajuar lexo: *Ajencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Fondi Sekretariat OK PK SK Kosovo od 1966-1967 g*, kutia nr. 15, dosja, nr. 18, fascikla broj 121, Ocena - Obim, vrsti, identik koraka, posle deformacije u SUP-u i DB-i i predlog mera za njihovo razresavanje u Kosovo Metohiju, Pristina, Septembra 1966.

³³ AMPJ, të Republikës së Shqipërisë, viti 1959, dosja, 555, B-VIII, 3-a, , fleta, 45.

tek popullsia shqiptare, qoftë dhe si lëvizje e tipit nacionalçlirimtare, siç është quajtur në kolokuialin e kohës. Fakti qëndron se këto ide patën dominancë nga kuadrat e PKJ-së, me origjinë serbo-malazeze, të cilët ishin të ngarkuar me trashëgimitë e politikave të mëhershme kundrejt kombit shqiptar.

Prandaj dhe lëvizjet me karakter emancipues të gruas shqiptare, jo vetëm që ishin të ngadalshme në dallim me republikat e tjera, por ishin dhe të ndrojtura, si pasojë e referencave që i trajtuam më sipër.

Kur flasim për emancipimin e gruas nuk mund të anashkalojmë zhvillimin e arsimit në Kosovë përgjatë periudhës 1945-1966. Në këtë periudhë në vija të përgjithshme arsimit fillor shqip mund të karakterizohet me disa elemente se kishte tendencë të likuidohet dhe të marrë tendencë të turqizohej dhe të serbizohej. Për realizimin e kësaj politike u përdorën disa metoda të shumëllojshme. Nga viti në vit kishte mbyllje të shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe, duke i shndërruar në shkolla serbe të përziera, me justifikimin e mungesës së kuadrit. Kjo formë e arsimimit me shkolla të përziera nga popullsia shqiptare, si pasojë e traditës, nuk u perceptua drejt dhe pati efekt negativ në shkollimin e vajzave. Për sa i përket teksteve shkollore për nxënësit shqiptarë ato ishin tërësisht të përkthyer nga gjuha serbe dhe nuk plotësonin nevojat e tyre. Ndërsa sipas ligjit për arsim të detyrueshëm, në hapësirën shqiptare nën Jugosllavi, ky ligj nuk është zbatuar në një përqindje të madhe, ashtu si në republikat e tjera.

Kur flasim për hapjen e shkollave, ato ishin në një numër shumë të vogël, ndonëse sipas një shënimi për të treguar gjoja të drejtat që kishin fituar pakicat kombëtare, në vitin 1953 u botua një libër i tipit statistikor, me titull “Nacionalne Manjine u Jugosllaviu”, ku ndër të tjera shkruhej se: “ në vitin 1952 kishte 623 shkolla shqipe me 81 438 nxënës³⁴”, ndërsa pesë vjet më vonë, më 1957, sipas gazetës *Rilindja*, “në vitin arsimor 1956/57 funksiononin 747 shkolla me gjithsej 81 427 nxënës shqiptarë³⁵”. Ndërsa një vit e gjysmë mbas këtyre të dhënave, përsëri gazeta *Rilindja* shkruan se; “...në Kosovë ka 268 shkolla në gjuhën shqipe dhe 149 shkolla të përziera, në të cilën mësojnë 83 212 nxënës të kombësisë shqiptare³⁶”. Nga këto të dhëna del se prej vitit 1952 deri në vitin 1958, shkollat shqipe nga 623 u ulën në 268, që do të thotë se gjatë kësaj periudhe u mbyllën

³⁴ Ljubisha Stojkovic dhe Millosh Martic, Nacionalne Manjine u Jugosllaviu, Beograd, 1952, f. 122.

³⁵ *Rilindja*, 21 mars 1957.

³⁶ *Rilindja* 19 tetor 1958.

355 shkolla shqipe. Natyrisht kjo politikë degraduese arsimore nuk ishte e paqëllimshme. Ajo udhëhiqej e sinkronizuar nga organet drejtuese jugosllave me synim që popullsinë shqiptare ta mbajnë në injorancë në mënyrë që të shfrytëzohet dhe gradualisht ta shkombëtarizojnë më lehtë dhe mos të mund të krijojë inteligjencën e saj.

Vetëm në vitet e '70-ta në Kosovë dhe viset e saj nën Jugosllavi, lëvizjet për emancipimin e gruas morën karakter më të theksuar pas viteve 1970, si pasojë e një marrëdhënie më të relaksuar në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Duhet të theksojmë se me hapjen e Universitetit të Prishtinës çështja e emancipimit të gruas shqiptare në Kosovë mori përmasa të zgjeruara. Një rol të rëndësishëm luajtën dhe marrëveshjet e ndërsjella në mes të institucioneve të Krahinës së Kosovës së atëhershme me institucionet e Tiranës³⁷. Kjo dha një efekt të gjithanshëm në ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve nën Jugosllavi sidomos në fushën e kulturës, arsimit dhe shkencës. Kjo periudhë shquhej për ardhjen e shumë akademikëve, pedagogëve, trupave teatrore dhe shoqërive kulturore e artistike nga Shqipëria në Kosovë, me të cilin rast u thyen shumë tabu për sa i përket luftës kundër analfabetizmit, emancipimin e gruas dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare duke u liruar nga disa stereotipe të së kaluarës dhe mospranimit të sllavizmit të kulturës shqiptare.

Vëzhgim më specifik i emancipimit të grave shqiptare në Kosovë

Në kontekstin e ri të Kosovës, të drejtat e grave u përmenden për herë të parë në raport me ligjin në Kushtetutën e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë të vitit 1946, të cilat ishin të bazuara sipas Kushtetutës sovjetike të vitit 1936 që e shpërfaqnin qëndrimin antipatriarkal dhe egalitar të revolucionit socialist.³⁸ Në këtë formë u ideua edhe Fronti Antifashist i Grave në Jugosllavi (1942-1953)³⁹, veprimtaria e së cilës njësi u përqendrua në emancipimin e grave dhe

³⁷ AMPJ, dosja, 1261, B/VII-2, viti 1978, titulli i dosjes: "Objektivat e Ministrisë së Arsimit për detyra të Kosovës e viseve, për vitin 1978", fleta 1-5.

³⁸ Chiara Bonfiglioli, "Women's Emancipation in Socialist Yugoslavia | CITSEE.Eu," accessed September 29, 2022, <https://www.citsee.eu/citsee-story/becoming-citizens-politics-women%E2%80%99s-emancipation-socialist-yugoslavia>.

³⁹ Chiara Bonfiglioli and Sara Žerić, "Working Class Women's Activism in Socialist Yugoslavia: An Exploration of Archives from Varaždin, Croatia," *Comparative Southeast European Studies* 70, no. 1 (March 28, 2022): 80, doi:10.1515/soeu-2021-0088.

përfshirjen e tyre në luftë kundër fashistëve, nazistëve dhe për ardhjen e komunistëve në pushtet.

Organizimet e grave shqiptare u bënë përmes aktivëve, që konsideroheshin si njësi përmes së cilave do të arrihej socializimi i grave edhe krijimi i raporteve për bashkëpunim ndërmjet grave. Kjo supozohej se do ta forconte ndjenjën e komunitetit por edhe angazhimin për kauzat politike:

‘Praktika ka tregue se mënyra ma e mirë për bashkimin e gjanë të grave n’organizatë asht formimi i aktivave për çështjet ma të ndryshme. Aktivat me i formue në mënyrë që gratë të cilat nuk kanë punë deri tash, e tregojnë interesim për ndonji çashtje të përshtatshme për to, të përfshihen në këta aktiva. Për të jetue këta aktiva nevojitet me u dhanë mbrendin e vazhdueshme të punës si dhe me mbajtë mbledhje me udhëheqset e aktivave dhe me aktivat në tansi.’⁴⁰ *Përgjatë funksionimit të tij, Fronti Antifashist i Grave organizoi disa konferenca, në të cilat delegatet i planifikonin dhe zyrtarizonin politikat përmes së cilave synonin të emanciponin gratë në Jugosllavi.*⁴¹ *Përderisa Fronti i Grave mund ta interpretojme sot si nismë feministe, duhet të shënohet që historiat i themelimit dhe veprimit të lëvizjeve emancipuese feministe, ndërkaq, nuk ishte homogjen në nivel të Jugosllavisë. Në vende si Sllovenia, Kroacia, madje edhe në Serbi, filozofia feministe ishte përhapur më parë te grupe të caktuara, andaj edhe veprimtaria për emancipim të përgjithshëm kishte histori më të gjatë dhe dukshmëri më të madhe të punës së këtyre frymëve. Ndërkaq në territore më konservatore e tradicionale, si Mali i Zi e Kosova, konceptet mbi emancipimin e grave ishin të njohura por jo të përhapura si filozofi përmes së cilave punohej në mënyrë aktive. Konteksti social e kulturor ishin përcaktues edhe për ecurinë e procesit emancipues edhe në atë kuptim kur ajo ishte nisur si politikë shtetërore për emancipim të grave në shoqërinë socialiste jugosllave pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Në këtë drejtim, Fronti Antifashist i Grave ia kishte vënë qëllim vetës emancipimin e grave që, siç e cilësonte Fronti, vinin nga ‘rajonet e prapambetura’, si: Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova,⁴² ligjërime këto me tone të qarta paternaliste.*

Karakteristikë për diskursin emancipues që zhvillohet gjatë kësaj periudhe është fakti që përkundër se çlirimi nga normat patriarkale

⁴⁰ Buletin, Nr. 17-18, Prishtinë, Vjeti II – 1948, f. 6.

⁴¹ Lura Limani, Mrika Limani, “Miti i luftëtares: analizë diskursive e literaturës mbi gratë kosovare në Lëvizjen Antifashiste në Kosovë pas LDB-së (Dorëshkrim)” n.d.

⁴² Chiara Bonfiglioli, “Women’s Emancipation in Socialist Yugoslavia | CITSEE.Eu,” 2.

promovohej si politikë nga lart, se emancipimi ironikisht shihej përmes thjerrëzave patriarkale. Kështu, gratë shqiptare në Luftën e Dytë Botërore kishin marrë rol të përkujdesjes ndaj pjesëmarrësve në luftë, ndërkaq pas luftës ato portretizoheshin në ligjërimet e sferës publike si shtylla e familjes që kishin primatin në ‘edukimin socialist’ të fëmijëve.

Megjithatë, pjesëmarrja e grave shqiptare në Luftën e Dytë Botërore shënohet si një hap historik që e shtyu përpara çështjen e përmirësimit të pozitës sociale dhe politike të grave në rendin ekzistues.⁴³

Një anakroni e tillë konceptesh në raport me emancipimin e majtë dhe riprodhimin e roleve tradicionale nuk iu nënshtrua kritikës publike, por u përforcua dhe u pranua si politikë shtetërore. Në këtë formë, emancipimi i grave ishte i ngadalshëm dhe pa ndonjë bërthamë filozofike. Petriqeviq e artikulon këtë situatë duke e shtruar pyetjen se nëse emancipimi i grave ishte proces në të cilin ato ishin objekt, ku emancipimi udhëhiqej nga politika shtetërore, ose nëse ishin subjekt, ku emancipimi ishte agjenci vetanake - për të cilën ajo pranon se nuk ka përgjigje përfundimtare.⁴⁴ Në anën tjetër, Vida Tomishiq, kryetare e Frontit e kishte popullarizuar idenë marksiste mbi situatën e grave në një shoqëri si matës i zhvillimit dhe civilizimit të po asaj shoqërie.⁴⁵ Pra, thelbi i punës së FAG nuk ishte detyrimisht i shkëputur nga idetë filozofike të emancipimit, porse përkthimi i tyre në praktikë nuk mund të konsiderohet i njëtrajtshëm. Kjo dilemë e parashtruar nga Petroviq, është më pak komplekse në rastin e Kosovës ku nismat emancipuese i shohim shumë shpesh si nismat politike të udhëhequra nga lart, posaçërisht sa i përket periudhës së hershme pas Luftës së Dytë Botërore. Vet Fronti i Grave u themelua më 1945 në Konferencën e parë të saj në Kosovë.⁴⁶ Që nga themelimi i saj deri te mbyllja, ndër nismat kryesore të Frontit mund të cilësojmë ligjin për ndalimin e mbajtjes së peçës dhe çarçafit (në kolokuialin e sotëm të njohura si shamia/mbulesa)⁴⁷ dhe nismat për të arsimuar gratë, të cilat

⁴³ Lura Limani, Mrika Limani, “Miti i luftëtares: analizë diskursive e literaturës mbi gratë kosovare në Lëvizjen Antifashiste në Kosovë pas LDB-së (dorëshkrim).”

⁴⁴ Paula Petričević, “How the Female Subject Was Tempered. An Instructive History of 8 March and Its Media Representation in *Naša Žena* (Our Woman),” *Comparative Southeast European Studies* 69, no. 1 (May 26, 2021): 40, doi:10.1515/soeu-2021-2001.

⁴⁵ Chiara Bonfiglioli, “Women’s Emancipation in Socialist Yugoslavia | CITSEE.Eu,” 2.

⁴⁶ Lura Limani, Mrika Limani, “Miti i luftëtares: analizë diskursive e literaturës mbi gratë kosovare në Lëvizjen Antifashiste në Kosovë pas LDB-së (dorëshkrim).”

⁴⁷ ‘Lëvizja për zhdukjen e çarçafit dhe të peçës merr përpjestime të gjera në vitin 1951, e sidomos pas kërkesës që i bëri Këshilli Krahinor i Kosovës e Metohisë Kuvendit Popullor të RPS për nxjerrjen e ligjit, me anë të të cilit duhej të ndalohej bartja e çarçafit. Në bazë

konsiderohen si nisma që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikuan në vendosjen e themeleve për emancipimin e grave. Bakija-Gunga e shënon një vëzhgim të rëndësishëm për këtë çështje:

'Karakteristikë për Kosovën deri më 1941 ishte prapambetja e madhe arsimore-kulturore, e kjo siç dihet, ishte pasojë e sundimit osman dhe e politikës së Jugosllavisë borgjeze, në të cilën shqiptarët nuk gëzonin as të drejtat më elementare nacionale dhe demokratike, të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare dhe të zhvillimit të kulturës nacionale. Sa i përket popujve të tjerë - serbëve dhe malazezëve, që bërë njëfarë përparimi, sepse për ta u hapën shkollat fillore dhe të mesme, ku ndiqnin mësimet në gjuhën amtare, ndërsa për shkollimin e pjesëtarëve të kombësisë shqiptare nuk u bë asgjë. Kjo gjë pati si rrjedhim rritjen e analfabetizmit, ku pjesën më të madhe e përbënin femrat, të cilat ishin shtresa më e shtypur dhe pa kurrfarë të drejtash në shoqërinë e atëhershme'.⁴⁸ Aspekti i largimit të mbulesës ndërlidhej edhe me propagandimet e grupeve të grave serbe dhe kroate të cilat flisnin për çlirimin e motrave të tyre myslimane (duke aluduar te boshnjaket dhe shqiptaret) për ta larguar shaminë, në mënyrë që t'i lihej udhë zhvillimit të humanizmit dhe progresit historik, gjegjësisht modernizimit socialist,⁴⁹ siç dëshmohet edhe nga mbledhjet relevante të kohës:

'(...) Nëpër punët e përditëshme të qëndrueshme kulturo-arsimore ndër gra, këshillat e Frontit të grave nëpër rrethe duhet ta forcojnë luftën kundra mbrapambetjes në mënyrën e jetës, me zhvillue luftë për një jetë ma të mirë e ma të kulturue kundra paragjykimeve edhe besëtytnive të ndryshme.

Çashtje shumë e rëndësishme në punën ndër gratë ma të mbrapambetuna asht likuidimi i analfabetizmit dhe hjekja e fexhes.

Përsa i përket çështjes së likuidimit t'analfabetizmit Plenumi ka nenvizue këto të meta: puna dhe influence e pamjaftueshme mbi nana që fëmijet e tyre t'a njekin shkollën (...)'⁵⁰

Për t'u përkthyer ky ligjërimit në kontekstin e sotëm, është e nevojshme që të shënojmë se pozita e grave në shoqërinë shqiptare gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore ishte padyshim dytësore, ku agjencia e

të kësaj kërkese dhe shumë të tjerave, që dërgoheshin nga organizatat e ndryshme dhe individë, më 25 mars të vitit 1951 u miratua Ligji mbi ndalimin e mbajtjes së peçës dhe të çarçafit'. Drita Bakija-Gunga, *Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist (1945-1978)* (Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1986), 82.

⁴⁸ Po aty., 88.

⁴⁹ Chiara Bonfiglioli, "Women's Emancipation in Socialist Yugoslavia | CITSEE.Eu," 3.

⁵⁰ *Buletin*, Nr. 17-18, Prishtinë, Vjeti II – 1948, 5.

pavarur e të cilave injorohej, ndërkaq vendimet për të merreshin shpeshherë në mënyrë arbitrare nga patriarku i familjes. Pra, pozita e saj i nënshtrohej plotësisht rregullave të hierarkisë patriarkale, dhe vendosja e mbulesës nuk është se konsiderohej vendim vetanak i gruas shqiptare, porse më tepër imponim social nga hierarkia ekzistuese. Për këtë arsye, edhe procesi i emancipimit të grave filloi nga parimi që pjesëmarrja në sferën publike si individë me identitet të tyre ishte hapi i parë drejt çlirimit.

Një aspekt tjetër i procesit emancipues është i lidhur me fushatën për arsimimin e grave. Sipas shifrave të kohës, del që niveli i analfabetizmit të gratë shqiptare ishte i lartë.⁵¹

‘Në Gjimnazin Real Shqiptar të Pejës gjatë vitit 1946-1947 vërehet një kthesë pozitive në regjistrimin e femrave. Prej 299 meshkujve të regjistruar, femra ishin 51 [...]. Në vitin shkollor 1949-1950 në Prizren u hap gjimnazi shqiptar për femra. ... Për shkak të pozitës së femrës në shoqërinë e atëhershme, interesimi për regjistrimin e femrave në këtë gjimnaz në fillim ishte i vogël. Për këtë qëllim, Drejtorati për Arsim e Kulturë i Këshillit Popullor Krahinor për Kosovë e Metohi kërkoi që të bëhej një agjitim më i madh si te anëtarët e Partisë të këtij rrethi, ashtu edhe te nëpunësit e pushtetit popullor dhe njerëzit përparimtarë në mënyrë që vajzat e tyre t’i dërgonin në këtë shkollë. Në vitin shkollor 1951-1952 ky gjimnaz kishte tri paralele me 76 nxënëse. Drejtoreshë e parë e këtij gjimnazi ishte Drande Tupeci.’⁵²

Pozita e pafavorshme ekonomike, arsimore dhe sociale ishte argument që përdorej vazhdimisht për të promovuar largimin e çarçafit:

‘Në raportin e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Metohi për vitin 1947 thuhet, ndër të tjera, se në aksionin për heqjen e çarçafit organizatat e Partisë kanë pasur sukses të dukshëm nëpër disa rrethe. Numri i femrave shqiptare që e hodhën çarçafin dhe peçën ishte afër 25 000’.⁵³

Siç e kronikon Drita Bakija-Gunga, vërehet që nisma e largimit të ferexhesë nuk ishte aq e lehtë sa partia honepsi në fillim. Meqë kjo traditë ishte e ngulitur thellë në strukturën shoqërore, kishte rezistencë të madhe për të larguar ferexhenë:

‘Por, pas të gjitha rezultateve që u arritën gjatë viteve 1947-1950, një pjesë bukur e madhe e femrave shqiptare ende ishin nën çarçaf. Një dukuri e

⁵¹ Drita Bakija-Gunga, *Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist (1945-1978)*, 88.

⁵² Po aty., 117.

⁵³ Po aty., 72.

këtu e pengonte mjaft punën në mesin e grave shqiptare, si dhe forcimin dhe masivizimin e organizatës së tyre. Për shkak të dobësive që pati aksioni për heqjen e çarçafit dhe të peçës gjatë vitit 1948, [...] duke rënë sërish nën ndikimin e reaksionit, nga 5 473 femrave, sa u zbuluan gjatë këtij viti, 4 296 përsëri e veshën çarçafin.⁵⁴

Sukses në këtë drejtim u arrit në momentin që bashkësia fetare u përfshi në këtë proces dhe në një mënyrë e aprovoi procesin e largimit të ferexhesë:

‘... me 27 maj 1947, në Prishtinë, u mbajt Konferenca e I e Ylemave, ku morën pjesë 221 hoxhallarë e shehlerë. Në këtë konferencë morën pjesë edhe anëtarët e Sekretariatit të Komitetit të Shqiptarëve të Kosovës e Metohisë me shokun Fadil Hoxha në krye dhe përfaqësuesit e Organizatës së FAG-ut. Pas një diskutimi të gjerë lidhur me heqjen e çarçafit dhe peçës, Këshilli i zgjedhur paraqiti rezolutën që u nënshkrua nga 217 përfaqësues të fesë islame me katër vota kundër.’⁵⁵

‘Lëvizja për zhdukjen e çarçafit dhe të peçës merr përpjestime të gjera në vitin 1951, e sidomos pas kërkesës që i bëri Këshilli Krahinor i Kosovës e Metohisë Kuvendit Popullor të RPS për nxjerrjen e Ligjit, me anë të të cilit duhej të ndalohej bartja e çarçafit. Në bazë të kësaj kërkesë dhe shumë të tjerave, që dërgoheshin nga organizatat e ndryshme dhe individë, më 25 mars të vitit 1951 u miratua Ligji mbi ndalimin e mbajtjes së peçës dhe të çarçafit.’⁵⁶

Referencat e tjera të periudhës na ndërtojnë një imazh të grave shqiptare të përfshira në procesin emancipues nga dy pozita kyçe: pozita e nënës/gruas në familje dhe pozita e punëtore. Për kontekstin e kohës, pjesëmarrja e grave shqiptare në fuqinë punëtore publike në vetvete shënoi një hap përpara në pozicionimin e saj në sferën publike dhe në këtë formë kjo përputhej me paramendimin e pozitës së saj në shoqërinë socialiste. Në anën tjetër, portretizimi i vazhdueshëm i saj si nënë/grua/kujdestare e familjes krijon asociacione të natyrshme me role tipike të shpërfaqura te regjimet totalitare të djathta.

Megjithatë, ka tendenca të qarta që gruaja shqiptare të portretizohet në ligjërimi me dimensione polihedrike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrëse aktive në luftë dhe vendimmarrje:

‘Si rezultat i themeleve të shëndosha, që ishin vu gjatë vjetit 1941, asht pjesëmarrja e një numri femrash të terënit të Gjakovës në njisit ushtarake

⁵⁴ Po aty., 78.

⁵⁵ Po aty., 76.

⁵⁶ Po aty.

*dhe lufta e tyne për çlirimin e vendit në vjetin 1944. Madje, në situatën më të vështirë – në një kohë gjatë vjetit 1942, kur shokët përgjegjës nuk kishin kurrfarë mundësije me qëndrue në qytet – përgjegjse e Partis u ba një femën: komunistja Safete Nimani.*⁵⁷

Procesi emancipues gjinor në kontekst të ideologjisë së majtë konsiderohet si kategori imperative për arritjen e barazisë në një shoqëri. Nuk është e rastit që në vetë programin e Partisë së Punëtorëve në Francë, ‘emancipimi i klasës prodhuese përfshin të gjitha qeniet njerëzore pa dallim gjinie ose race’.⁵⁸ Por, ideali socialist parashihte rivendosjen e pozitës së gruas nga puna domestike në punë publike, pra që pjesëmarrja e grave të jetë në prodhim publik dhe nga aty e tutje pëson transformim social.⁵⁹ Këtu mbase e shohim edhe dallimin konceptual për qasjen ndaj emancipimit, sepse përderisa për feministet marksiste, shtypja është para së gjithash produkt nga kapitalizmi që e ka prodhuar patriarkatin, për feministet socialiste, patriarkati i paraprinë kapitalizmit. Nëse e vendosim temën tonë në këtë kanal ligjërimi, atëherë mund të vërejmë që patriarkati dhe ‘mikro-borgjezia’ dhe ‘feudalizmi’ siç përdoren si terme në burimet e kohës, janë si të barabarta në kuptim të shtypjes ndaj grave. Por, një element që nuk bie në sy në referencat e kohës është fakti që puna domestike nuk njihet si punë - përderisa pjesëmarrja e grave në sferën publike cytet përmes agjitacionit, e roli i grave si shtyllë domestike trajtohet si i natyrshëm dhe i mbyllur për diskutim.

⁵⁷ Nazmije Nimani, “Pjesëmarrja e grave të Gjakovës në Lëvizjen Nacionalçlirimtare të vjetit 1941,” *Përparimi*, no. 3 (March 1962): 116.

⁵⁸ Lise Vogel, *Marxism and the Oppression of Women: Toward a Unitary Theory*, Historical Materialism Book Series 45 (Leiden: Brill, 2013), 75.

⁵⁹ Po aty., 93.

Mrika LIMANI-MYRTAJ
Fatmir ARIFI

SUMMARY

A REVIEW ON THE EMANCIPATION PROCESS OF ALBANIAN WOMEN IN THE 20TH CENTURY

The paper discusses the process of emancipation of Albanian women throughout several historical periods, with a particular focus on the period during the First and Second World War. The paper notes that certain ideologies have been historically proven to have a more progressive approach in relation to the process of women's emancipation, and these ideologies were often leftist in nature. The arguments presented in the papers contribute to a discourse analysis of the economic, social, political, cultural, and traditional factors that paved the way for the the emancipation of Albanian women. This process is contextualized as an evolutionary one as opposed to a revolutionary process, a contradiction which is notable in the process of the emancipation of Albanian women and not women on a global scale. The one outstanding exception is the period of the Second World War, when Albanian women took an active role in political decision-making.

The paper argues that only when there are global turbulences, the discussion on women's rights comes to the fore. Furthermore, it becomes apparent that they surface not necessarily as a progressive ideological agenda, but rather because of the demographic shift in the workforce. The paper also contextualizes the strategies that the state (Yugoslavia) used to emancipate Albanian women - even in cases when it was considered as a patriarchal hierarchical project. The process of education and eradication of illiteracy, as well as the campaign to remove the headscarf, took a central role in this process during the period in question.